



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Datë: 03.05.2023

AUTORITETI:

Me kërkesë të Sektorit për punë të Kuvendit Komunal të datës 27.04.2023, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim hartoi :

I N F O R M A T Ë

MBI PREGADITJET NDAJ EMERGJENCAVE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

I. Misioni i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është që mbrojë njerëzit, pronën dhe ambientin e komunës së Gjakovës nga fatkeqësitë natyrore dhe fenomenet tjera kërcënuese. Prioritet parësor është paranadalimi apo zvogëlimi i humbjes së jetërave të njerëzve, të të mirave materiale, mbrojtjen e pronës, infrastrukturës dhe peisazhit natyror, përmes planifikimit, gadishmërisë dhe reagimit emergjentë, si dhe kthimit në normalitet pas fatkeqësisë.

II. Në realizimin e këtyre objektivave, kjo Drejtoria, detyrat dhe përgjegjësitë e saj i realizon në koordinim dhe bashkëpunim me mekanizmat institucional të paraparë për reagim në situata emergjente, si:

1. Shtabi Komunal për Emergjencë,
2. Policia e Kosovës,
3. Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe KFOR-i,
4. Agjencia e Menaxhimit Emergjent/MPB,
5. Shërbimi Zjarrfikës,
6. Institucionet e kujdesit parësor dhe dytësor shëndetësor në komunë,
7. Kompanit publike si: HS “Radoniqi”, KRM “Çabrat”, KEDS, e të ngjag
8. Operatorët ekonomik për intervenime emergjente dhe operatorët tjerë kontraktues
9. Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega në Gjakovë, dhe OJQ që veprojnë

GJENDJA AKTUALE DHE PREGADITJET PËR SITUATA EMERGJENTE

Pasqyra e përgjithshme emergjente në teritorin e komunës së Gjakovës gjatë v.2022 dhe tremujorit të parë të këtij viti vlerësohet të jetë stabile, përkundër faktit se teritori i saj kohë pas kohe është

ballafaquar me disa fenomene natyrore të cilat kanë detyruar Drejtorinë të ndërmerre masa të mobilizimit të kapaciteteve njerëzore e teknike për reagim emergjent.

Vlenë për tu theksuar se nga të gjitha fenomenet natyrore më së shpeshti jemi përballur me vërshimet, zjarret, erërat e forta dhe rrëshqitjet e tokës.

III. Sa i përket **vërshimeve**, situatë më serioze kemi pas në periudhën shtator-nëntor/2023, sidomos më problematike kanë qenë vërshimet e natyrës urbane, të objekteve të biznesit dhe sipërfaqeve bujqësore. Në kontekst të situatës së krijuar është aktivizuar Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Vërshimet të cilët kanë evidentuar dhe përpiluar Raportin e përgjithshëm të dëmeve dhe i njeiti përmes Kryetarit të Komunës i është dërguar nivelit qeveritar për kompensim eventual, pasi që komuna nuk posedon fond për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Ndërsa, sa i përket dëmeve në infrastruktur nuk është evidentuar ndonjë dëmë specifik shtesë, pasi ato situata kanë qenë të përsëritshme dhe gjendja e tyre është identike me vitet e kaluara.

Pasqyrra e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet gjatë vitit 2022

#	PROFILI I DËMIT	NUMRI I RASTEVE	VLERA E DËMIT
1.	Ekonomi familjare	197	305,742.00 €
2.	Subjekte afariste	45	1,457,834.00 €
3.	Kultura bujqësore	51	302,123.00 €
	Gjithsejtë:		2,065,699.00 €

IV. Marrë në përgjithësi situata me **zjarret** gjatë vitit 2022 dhe tremujorit të parë të këtij viti ka qenë më e qetë, për faktin se ka një rënie të lehtë të numrit të rasteve djegjes së hamullishteve gjatë këtij fillim viti, gjë që është për tu vlerësuar,.....por edhe gjatë sezonës së zjarreve në vitin e kaluar nuk patur zjarre pyjore dhe fushore të përmasave të mëdha, krahasuar me vitet e kaluara.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera
për periudhën kohore: **Janar - Dhjetor 2022** - Komuna e **Gjakoves**

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2022														
2022	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsejt
								zj.	qyt.	tot.	zj.	qyt.	tot.	
Janar	28	20	6	2										28
Shkurt	22	14	4	4										22
Mars	95	85	4	5	1				3					95
Prill	34	27	6	1										34
Maj	56	48	2	5			1	1						56
Qershor	55	46	6	3								1		55
Korrik	51	40	5	5			1							51
Gusht	65	53	11	1										65
Shtator	58	11	8			38	1		2					58
Tetor	27	16	7	4					1					27
Nëntor	34	12	6	2		13	1							34
Dhjetor	34	12	5	1	1	15								34
Gjithsejtë	559	384	70	33	2	66	4	1	6	0	0	1	0	559

Përndryshe, zjarret në amvisëri, zjarret aksidentale teknologjike dhe në subjekte afariste kanë qenë në nivelet e viteve të mëparshme, ku përveç humbjeve materiale është regjistruar 1 humbje jete (në ndërtesë kolektive).

Sipas planifikimit buxhetor për vitin 2023, nga pozicioni i investimeve kapitale kjo Drejtoria ka planifikuar furnizimin me një autocisterne zjarrfikëse me kapacitetet 8000 litra/ujë dhe të një automjet tereni për nevoja komanduese në zona të thella malore. Këto dy furnizime tashmë janë tenderuar, për autocisternë veç është lidhë kontrata mes Komunës së Gjakovës dhe Operatorit përzgjedhur ekonomik. Vlenë për tu potencuar se ky është furnizimi i parë me automjete me kilometrazhë zero që nga viti 1999 nga buxheti i komunës. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim planifikon që nga linja buxhetore - investime kapitale me kornizën buxhetore 2023-2025 të furnizohet edhe me dy automjete tjera, të cilat dukshëm do ta ngritin gatishmërinë në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe të sigurisë së përgjithshme publike në komunë.

Aktualisht, përqendrimi i Drejtorisë është në marrjen e masave dhe veprimeve për ngritjen e gadishmërisë operacionale për shuarjen e zjarreve sezonale.

V. Për shkak të ndryshimeve klimatike dhe shpeshimit të reshjeve atmosferike, disa pjesë të teritorit të komunës po ballafaqohen me fenomenin e rrëshqitjeve të tokës, me ç'rast kemi dëmtime të objekteve të banimit, të infrastrukturës publike, erozionit dhe degradimit të shtertërve të lumenjëve etj. Në bazë vlerësimit të kësaj Drejtorie, trendi i rrëshqitjeve të tokës është rritje e sipër, kështu që duhet të rritet vëmendja institucionale ndaj kësaj dukurie natyrore, parandalimi i së cilës mund të bëhet vetëm me planifikim të mirëfilltë, qoft me ngritjen e mureve mbrojtëse (për objekte banimi dhe infrastrukturën publike), me rregullimin e shtretërve të lumenjëve, krijimin e kaskadave në brigjet e thepisura si dhe mbëlltimin e drunjëve në terene të hapta të cënueshme nga fenomeni i rrëshqitjeve të tokës.

VI. Qendra Komunale të Thirrjeve Emergjente-112 e cila vepron si njësi në kuadër të kësaj Drejtorie është plotësuar edhe me 4 zyrtar për telefoni, dhe me përbërjen e saj aktualisht i plotëson kriteret që të veprojnë si Qendër Operative Rajonale-112 në kuadër të Sistemit Unik të Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (SUAKE-112) me operim 24/7. Përndryshe, gjatë vitit paraprak në këtë Qendër pranuar gjithsej **25.079** thirrje dhe janë menaxhuar **680** raste me strukturat reaguese dhe shërbyese si: Zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, FSK, KFOR, Kryqin e Kuq, KRU Gjakova, KEDS, KRM “Çabrat”, OJQ ,etj.

VII. Për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, pastaj shtimit të kërkesave të personave fizik dhe juridik, por edhe të rritjes së kostos së shërbimeve emergjente, Kontratat Dyvjeçare në dy vitet e fundit janë mbyllur shumë para afatit së paraparë me kontratë. Ndaj në këto rrethana, me kornizën afatmesme buxhetore, Drejtoria e ka të domosdoshme rritjen e mjeteve buxhetore për kontraktimin e shërbimeve emergjente.

Nga janari/2022 e deri në muajin prill të këtij viti përmes operatorit ekonomik janë realizuar 23 intervenime emergjente në tërë teritorin e komunës. Kryesisht kanë qenë ndërhyrje emergjente në kohë reale për parandalimin apo zvogëlimin e pasojave të nga fatkeqësitë e shkaktuara. Derisa në mënyrë preventive janë realizuar disa intervenime emergjente në pastrimin e shtretërve të lumenjëve, përrockave, kanaleve e të ngjajshme, të tilla intervenime do të realizohen edhe këtë vit para hyrjes në sezonës e reshjeve vjeshtë-dimër.

VIII. Gjatë kësaj periudhe informuese, teritori i komunës është ballafaquar edhe nga **erërat e forta**, por për dallim nga rajonet tjera të Kosovës, dëmet nga kjo fatkeqësi natyrore tek ne janë relativisht të vogla, pasi bëhet fjalë vetëm për disa raste të izoluara.

IX. Bazuar në në legjislacionin në fuqi që determinon mbrojtjen dhe sigurinë nga fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat tjera të mundshme, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në vazhdimësi ushtron kompetencat e saja si në vijim:

- Identifikimi, monitorimi dhe hulumtimi permanent i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera që kërcënojnë komunën e Gjakovës;
 - Njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi i qytetarëve për rreziqet e pashmangshme dhe dhënja e udhëzimeve për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave eventuale nga fatkeqësitë natyrore;
 - Mbikqyrja e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve tjera normative që rregullojnë funksionimin e sistemit të emergjencave civile në komunë;
 - Reagimi ndaj situatave emergjente në komunë .
 - Organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
 - Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - Trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmë;
 - Koordinimi me strukturat e nivelit lokal, ndërkomunal dhe qendror në funksion të zbatimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - Hartimi dhe azhurnimi i Planit të vlerësimit të rreziqeve dhe planeve operative për mbrojtje nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera;
 - Programimi dhe planifikimi i mjeteve buxhetore dhe logjistike për realizimin i projekteve për parandalimin e rreziqeve, gatishmëri, për reagim në fatkeqësi dhe sanim të gjendjes pas fatkeqësisë;
-

